

L I G J
Nr.8145, datë 11.9.1996

PËR TË DREJTËN E TUBIMEVE

Në mbështetje të nenit 21 të ligjit nr.7691, datë 31.3.1993 “Për një shtojcë në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, kreu “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, si dhe të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I

Neni 1

Në Republikën e Shqipërisë gjithë shtetasit, pa asnjë dallim për shkak të seksit, racës, ngjyrës, gjuhës, besimit, etnisë, gjendjes ekonomike e financiare, arsimore e sociale, të bindjeve politike, përkatësisë prindërore ose të çdo lloj rrethane tjetër vetjake, kanë të drejtë për tubime publike.

Neni 2

Në zbatim të këtij ligji me tubim do të kuptojmë grumbullimet, manifestimet, mbledhjet, procesionet dhe parakalimet, në të cilat pjesëmarrësit shprehin lirisht dhe në mënyrë paqësore pikëpamjet e tyre për çështjet që u interesojnë.

Neni 3

“Vende publike”, në kuptimin e këtij ligji, konsiderohen sheshet, bulevardet, rrugët dhe çdo mjedis tjetër që shfrytëzohet lirisht për lëvizjet e qytetarëve e të automjeteve.

Neni 4

Për tubimet në vendet publike organizatorët detyrohen të kërkojnë lejen me shkrim të shefit të komisaritit të policisë, në territorin e të cilit do të zhvillohen, jo më vonë se tri ditë përpara.

Neni 5

Kur tubimet zhvillohen në “vende të hapura për publikun”, si stadione, salla kinemaje, teatri e të tjera mjedise të këtij lloji, nuk nevojitet leja me shkrim nga organet e policisë.

Neni 6

Kur nevojitet leja për zhvillimin e tubimit, në kërkesën me shkrim drejtuar shefit të komisaritit të policisë duhet të përshkruhet:

- a) identiteti dhe adresa e organizatorëve;
- b) qëllimi i tubimit;
- c) data, vendi dhe koha e fillimit dhe e mbarimit të tubimit;
- ç) numri i përafërt i pjesëmarrësve.

Neni 7

Shefi i komisaritit të policisë, kur e gjen kërkesën të ligjshme, e miraton dhe jo më vonë se 24 orë para fillimit të tubimit njofton me shkrim organizatorët.

Neni 8

Shefi i komisariatit të policisë mund të refuzojë dhënien e lejes për zhvillimin e një tubimi, për shkak të sigurimit të rendit ose të qetësisë publike, në rastet kur:

- a) zhvillimi i tubimit mund të kufizojë ose të dhunojë liritë dhe të drejtat themelore të shtetasve të tjerë;
- b) pengohet transporti dhe një pengim i tillë bie ndesh me interesat e qytetarëve;
- c) ka të dhëna të besueshme për kryerjen e veprave penale ose të veprimeve të dhunshme;
- ç) në të njëjtin vend dhe kohë me zhvillimin e tubimit është planifikuar një tjetër ose mund të pengohet një veprimtari me karakter kombëtar.

Në këto raste shefi i komisariatit të policisë njofton me shkrim organizatorët e tubimit jo më vonë se 24 orë para zhvillimit, duke parashtruar edhe shkaqet e refuzimit.

Neni 9

Organizatorët janë të detyruar të marrin masa për zhvillimin normal të tubimit.

Me kërkesën e tyre, organet e policisë mund të bashkëpunojnë për mbajtjen e rregullit dhe të marrin masa për mënjanimin e personave që kërkojnë ta prishin atë.

Neni 10

Gjatë zhvillimit të tubimit organizatorët dhe pjesëmarrësit detyrohen t'i përmbahen rreptësisht qëllimit të përcaktuar qysh më parë në kërkesën e bërë shefit të komisariatit të policisë.

Neni 11

Pjesëmarrësit duhet të largohen nga vendi i tubimit brenda kohës së caktuar.

Neni 12

Pjesëmarrësve në tubim u ndalohet mbajtja e armëve të çfarëdolloji, edhe sikur të jenë të pajisur me lejen përkatëse nga organet kompetente. Gjithashtu, u ndalohet edhe mbajtja e maskave.

Neni 13

Përfaqësuesit e organeve të policisë mund të jenë të pranishëm gjatë zhvillimit të tubimeve në vendet publike.

Neni 14

Në rastet kur organizatorët a pjesëmarrësit në tubim hedhin parrulla ose përdorin simbole antikushtetuese, ose të tilla që nxitin të tjerët për veprime të dhunshme, kryejnë veprime të tilla ose të tjera që përbëjnë vepra penale, shefi i komisariatit të policisë, ose persona të tjerë të autorizuar prej tij, urdhërojnë ndalimin e tubimit dhe shpërndarjen e pjesëmarrësve.

Neni 15

Kur pjesëmarrësit në tubim, me gjithë thirrjet e qarta të policisë, nuk shpërndahen, shefi i komisariatit ose personi i autorizuar prej tij, urdhëron shpërndarjen forcërisht të tyre, pasi i ka paralajmëruar më parë se do të përdoret forca.

Neni 16

Në shpërndarjen e tubimeve të paligjshme, por jo të dhunshme, organet e policisë duhet t'i

shmangen përdorimit të forcës. Kur një gjë e tillë është e pamundur, duhet ta kufizojë përdorimin e saj në një masë dhe shtrirje minimale të domosdoshme.

Neni 17

Pengimi në ushtrimin e së drejtës për tubim, organizimi dhe pjesëmarrja në tubime të paligjshme, si dhe organizimi i tubimeve me pjesëmarrje të personave të armatosur, përbëjnë vepra penale dhe dënohen sipas neneve 261, 262 dhe 263 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 18

Dekreti nr.7408, datë 31.7.1990 “Për mbledhjet, grumbullimet dhe manifestimet e shtetasve në vendet publike”, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie ndesh me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 19

Ngarkohet ministri i Brendshëm të nxjerrë udhëzime në zbatim të këtij ligji.

Neni 20

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.1603, datë 17.9.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha